

V E N D I M
Nr.759, datë 11.11.1996

**PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE TË TRANSFORMUARA NË
SHOQËRI TREGTARE**

Në mbështetje të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, dhe me propozimin e Ministrisë së Privatizimeve dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Agjencia Kombëtare e Privatizimit bën shitjen e aksioneve të ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare në bazë të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”.

2. Kërkesë në këtë vendim do të kuptohet sasia e letrave me vlerë që investohen për të blerë aksione në shoqëritë tregtare që privatizohen.

Ofertë në këtë vendim do të kuptohet kapitali themeltar apo pjesë e tij të shoqërive tregtare që shpallen për privatizimin. Kapital themeltar në këtë vendim konsiderohet kapitali i shoqërisë që figuron në vendimin e gjykatës për regjistrimin e shoqërisë si person juridik. Pjesë e pandarë e këtij kapitali është vlera e truallit brenda kufijve të shoqërisë.

3. Forma e privatizimit të aksioneve të shoqërive tregtare është ankandi. Mekanizmi i zhvillimit të ankandit të aksioneve është ai pa çmim të llogaritur, sipas të cilit oferta dhe kërkesa për aksione të shoqërisë që do të privatizohet, shkojnë gjithnjë paralelisht.

Mënyra e shpërndarjes së kapitalit fillestar ose aksioneve do të jetë ajo përpjesëtimore, që do të varet nga rezultatet përfundimtare të raportit kërkesë-ofertë, si pasojë e arritjes së vlerës së tregut në një periudhë të caktuar kohe.

I. Kur kërkesa e tejkalon ofertën, aksionet shpërndahen në përpjesëtim të drejtë me sasinë e letrave me vlerë (bonove të privatizimit) të ofruara nga kërkuesit.

II. Kur kërkesa është jo më e madhe se oferta, ankandi përfundon dhe gjithë aksionet e shoqërisë shpërndahen në mënyrë përpjesëtimore me sasinë e letrave me vlerë të ofruara nga kërkuesit.

4. Ish-pronarët e truallit, si subjekte kërkuese, në dallim me subjektet e tjera kërkuese, në bazë të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, kanë të drejtë të marrin aksione në shoqërinë që privatizohet, në përpjesëtime që i përgjigjen vlerës së truallit të njohur, në bazë të vendimit përkatës të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Vlera e truallit përcaktohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.6.1994.

Ish-pronari i truallit, për vlerën e truallit si pjesë e kapitalit themeltar të shoqërisë, nuk merr pjesë në ankandin e aksioneve.

Atij i lind e drejta për t’u kompensuar me një përqindje të caktuar të aksioneve, e cila mbetet e pandryshuar në raport me pjesën tjetër të kapitalit të shoqërisë, pavarësisht nga rezultatet e ankandit. Brenda afatit të paraqitjes së kërkesave ish-pronari i truallit paraqet një kërkesë me shkrim në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, në të cilën shpreh vullnetin e tij se kërkon që të zotërojë aksione në kapitalin e shoqërisë që privatizohet, për aq sa kërkon dhe në përpjesëtim me vlerën e truallit që atij i njihet nga vendimi përkatës.

Ish-pronari i truallit, bashkëngjitur kërkesës së tij, paraqet në AKP ose në degët e saj vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, së bashku me gentplanin e hartuar nga ky komision, dëshmi trashëgimie dhe prokurë përfaqësimi të posaçme. Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë origjinal ose i njëzuar me të.

Kur ish-pronari i truallit nuk paraqet kërkesë dhe dokumentacion të plotë të përcaktuar sipas këtij vendimi, atëherë Agjencia Kombëtare e Privatizimit bën shpërndarjen e kuotës përkatëse tek aksionarët ekzistues, në proporcion me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në kapital.

5. Procedura e privatizimit të shoqërive tregtare ka element kohor:

a) Valë privatizimi, me të cilën kuptohet periudha, gjatë së cilës përfundohet shitja e disa grupeve shoqërish tregtare të ofruara për shitje.

b) Raund privatizimi, me të cilin kuptohet periudha, gjatë së cilës hidhet për privatizim një grup i caktuar shoqërisht; brenda një vale do të ketë disa raunde privatizimi. Raundi i privatizimit zgjat jo më shumë se 45 ditë.

6. Ministria e Privatizimeve paraqet në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit urdhrin e ministrit të Privatizimeve për privatizimin e shoqërive tregtare, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës të secilës shoqëri tregtare, i cili do të përcaktohet në udhëzimin përkatës.

Branda 10 ditëve nga marrja e dokumentacionit Agjencia Kombëtare e Privatizimit shqyrton rregullsinë e tij dhe i kthen Ministrisë së Privatizimeve dokumentacionin që konsiderohet i parregullt.

Agjencia Kombëtare e Privatizimit fillon procedurën e privatizimit me publikimin, për një periudhë kohe jo më pak se 15 ditë, për shitjen e aksioneve të shoqërive tregtare.

Publikimi bëhet në tri gazeta me qarkullim kombëtar të paktën 6 herë, në gazetën lokale të paktën dy herë dhe në rrethin ku ndodhet shoqëria vendosen afate, ndër të cilat detyrimisht në zyrën e regjistrimit të kërkesave, në qendrën e qytetit dhe në qendrën e shoqërisë që privatizohet ose në të gjithë pjesët e saj.

7. Pas përfundimit të afatit të publikimit për grupin e parë të shoqërive fillon vala e njëkohësisht raundi i parë i privatizimit.

Gjatë periudhës së zgjatjes së raundit kryhet procedura e regjistrimit të personave fizikë e juridikë, duke porositur aksione të shoqërive në shkëmbim të letrave me vlerë.

Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë të porosisin aksione për çdo shoqëri tregtare të shpallur për shitje, në mënyrë të njëkohshme në të gjitha qendrat e ankandeve të degëve të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe, pavarësisht nga vendndodhja e shoqërisë tregtare.

Përfundimi i periudhës së regjistrimit (ose porosisë për blerje aksionesh) shënon edhe përfundimin e privatizimit të kapitalit (ose pjesëve të tij) të shoqërisë sipas shpalljes.

Gjatë procedurës së privatizimit nuk bëhet asnjë ndryshim në dokumentacionin e shoqërisë.

8. Deri 7 ditë nga dita e mbylljes së ankandit Agjencia Kombëtare e Privatizimit dorëzon në Qendrën e Informatizimit Financiar formularët e kërkesave të grumbulluara për aksione të shoqërive tregtare të shpallura për shitje.

Qendra e Informatizimit Financiar, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të formularëve, për çdo rast të përcaktuar në paragrafët I, II të pikës 3 të këtij vendimi, jep rezultatin përfundimtar tek Agjencia Kombëtare e Privatizimit për pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë të secilit subjekt kërkuar.

Rezultatet përfundimtare të ankandit miratohen nga Komisioni i Ankandit, i cili ka këtë përbërje:

Përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit kryetar

Përfaqësuesi i Ministrisë së Privatizimeveanëtar

Përfaqësuesi i Qendrës së Informatizimit Financiaranëtar

Rezultatet përfundimtare të ankandit hartohen në katër kopje, nga të cilat një i dërgohet shoqërisë tregtare të privatizuar, një kopje i dërgohet Ministrisë së Privatizimeve, një i dërgohet Qendrës së regjistrimit të aksioneve dhe një kopje ruhet në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit.

9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Privatizimeve, Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe Qendra e Informatizimit Financiar.

10. Të gjitha aktet nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

kryetari i këshillit të ministrave

Aleksandër Meksi